



VENDIM

Nr. 24, Datë 13/07/2017

Mbi

**Miratimin e "Deklaratës të misionit të UART për vitet akademike
2018-2020"**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 13/07/2017, në zbatim të nenit 38 (Funksionet e Senatit Akademik) të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pasi shqyrtoi Relacionin e Rektoratit të UART, "Mbi miratimin e deklaratës të misionit të UART për vitet akademike 2018-2020", dhe pasi e diskutoi:


VENDOSI

1. Miratimin e "Deklaratës të misionit të UART për vitet akademike 2018-2020".
2. Bashkëlidhur, dokumenti i "Deklaratës të misionit të UART për vitet akademike 2018-2020".


Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI  Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA) 

Prof. Dr. Isak SHEHU  Prof. Petrit MALAJ 



Prof. Asoc. Ardian ISUFI  Prof. Sadik SPAHIJA 

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)  Prof. Najada HAMZAJ 

Prof. Fatmir MIZIRI  Prof. Ilir MARTINI 

Prof. Gazmend GJOKA  Prof. Miltiadh KUTALI 

Prof. Petrika AFEZOLLI  Prof. Bujar SYKJA 

Prof. Dr. Erald BAKALLI  Prof. Asoc. Elvis RUDI 

Prof. Asoc. Albes FUSHA  Nansy GJERAZI 

Rafael HOXHA



Universiteti i Arteve

Deklarata e misionit të Universitetit të Arteve (2018-2020)

Deklarata e misionit është përgatitur nga grupi i punës i përbërë si më poshtë:

1. Prof.Kastriot ÇAUSHI,
2. Prof.Petrit MALAJ
3. Prof.Asoc.Ardian ISUFI,
4. Prof.Dr. Isak SHEHU
5. Alma SINANAJ
6. Prof.Dr. Erald BAKALLI,
7. Prof. Asoc. Dr. Elida RAPTI
8. Prof. Milto KUTALI
9. Prof. Ilir MARTINI,
- 10.Prof. Arben LLOZI,
- 11.Prof.Asoc.Kastriot TUSHA,
- 12.Prof.Asoc.Dorian CENE
- 13.Msc. Elia ADEMI/PLAKU,
- 14.Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI,
- 15.Prof.Asoc. Albes FUSHA,
- 16.Prof.Asoc.Pjerin KOLNIKAJ
- 17.Adriatik KRAJA



DEKLARATA E MISIONIT E UNIVERSITET TË ARTEVE

PËR VITET AKADEMIKE 2018-2020

Politika e programit

1. Përshkrimi i programit;

Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i Arsimit të Lartë me karakter artistik në Shqipëri, që ofron Diplomë Universitare "Bachelor", dhe "Master i Shkencave/Master i Arteve", "Master Profesional" në Muzikë, në Arte të Bukura dhe në Artet Skenike. UA ofron dy cikle studimi nëpërmjet sigurimit të standardeve duke ndërthurur në mënyrë më efektive mësimdhënien me përgatitjen e studenteve me aktivitetin e tyre artistik të mëvonshëm por edhe gjatë studimeve.

2. Përshkrimi i Politikës së programit;

Universiteti i Arteve përbëhet nga tre Fakultete dhe konkretisht, Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Arteve të Bukura dhe Fakultetin e Artit Skenik. Aktualisht është institucioni unik në vend për përgatitjen e talenteve të reja në të gjitha fushat e artit dhe që ka marrë përsipër të sjellë prurjet më të mira, më kompetitive e më origjinale për institucionet artistike të vendit si dhe për jetën shoqërore e artistike dhe produktin shpirtëror shqiptar në të gjitha trevat shqipfolëse. Në këtë parim mbështetet edhe qëllimi i rritjes së standardeve të UA, për të arritur në ato evropiane, duke u mbështetur në zgjerimin e kapaciteteve krijuese të brendshme si dhe duke qenë pjesë aktive e aktiviteteve të zhvilluara dhe jashtë saj. Kjo formë e re e mbështetur nga të gjithë treguesit potencial të UA ka rritur edhe integrimin në mësimdhënie si homologët e saj në Evropë.

3. Qëllimi i Politikës së programit;

Qëllimi kryesor i saj është të ofrojë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fushën e artit dhe të kulturës, të thellojë kualifikimin profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës, si dhe të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit. Nëkurikulën mësimore universitare dhe sidomos në vitet e fundit janë përfshirë lëndë në programet e studimit, duke e bërëkurikulën e Universitetit të Arteve të barasvlershme me si-motrat e saj në Evropë, por dhe duke u mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi





4. Objektivat kryesore për vitin 2018-2020

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në të gjitha programet e ofruara nga UA, nëpërmjet:

- Stimulimit i rishikimit periodikisht të kurikulave mësimore, nga stafi i brendshëm dhe ai i ftuar për një avancim të tyre në përputhje me standardet evropiane, në bashkërendim kjo edhe me studentët sipas problematikave të tyre.
- Përmirësimi i metodës së mësimdhënies duke i krijuar stafit pedagogjik mundësi aksesit nga biblioteka e UA direkt në auditorin e mësimin nëpërmjet sistemit on-line të përfutimit të literaturës nga pedagogët. Ky akses është i vlefshëm edhe për studentët e UA si dhe stafin akademik, kudo që ato mund të jenë.
- Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet zgjerimit të sistemit universitar, me Universitete të tjera në rajon dhe në Evropë.
- Zgjerimit të ambienteve të UA nëpërmjet ndërtimit, rikonstruksionit të ndërtesave ekzistuese.
- Ngritjes së laboratorëve sipas kërkesave të fakulteteve.
- Shtimit të numrit të stafit akademik dhe administrativ në të tre Fakultetet e UA.
- Shtimit të numrit të studentëve në të tre Fakultetet e UA.

Produktet kryesore që do të ofrohen në 2018-2020

- 32 programe studimi për të tre Fakultetet e UA për ciklin e parë të studimeve Bachelor.
- 27 programe studimi për të tre Fakultetet e UA për ciklin e dytë të studimeve Master i Arteve.
- 4 programe studimi për Fakultetin e Muzikës në UA për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional.
- 1 program studimi për Fakultetin e Muzikës në UA për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave.
- Hapjen e programeve të ciklit të tretë doktoratë.
- Përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme me synim arritjen e standardeve për realizimin e kushteve optimale për zhvillimin e programeve mësimore të lëndëve që ofron UA.
- Infrastrukturë mbështetëse e mësimdhënies e përmirësuar duke plotësuar laboratorët, sallat, klasat, atelierët dhe studiot me pajisje, mjete, lëndë të para, materiale dhe elemente të tjerë të mësimdhënies.
- Programe mësimore të menaxhuara me efektivitet, cilësi dhe transparencë,
- Bibliotekë e integruar dhe në shërbim të studentëve, akademikëve, artdashësve me një literaturë të abdetuar dhe të digjitalizuar.
- Mësimdhënie me kushte të përmirësuara dhe në përshtatje me programet mësimore duke synuar standardin.
- Punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar.
- Punonjës akademik e administrativ të kualifikuar dhe në përshtatje me zhvillimet teknologjike, gjithmonë në rritje dhe në mbështetje të procesit mësimor të Universitetit të Arteve.





- Rikualifikim hapësinor i sipërfaqeve të mësimdhënies.
- Ambiente të ndërtesave ekzistuese të mirëmbajtura apo të ri konstruktura.
- Program studimor për perspektivën e zhvillimit të UA ku përfshihen projekte ndërtimore, projekte për rikonstruksione dhe të tjera projekte në mbështetje të mësimdhënies duke synuar standardet.

5. Objektivat kryesore për kërkimin shkencor 2018-2020

Hapja e programeve të ciklit të tretë të studimeve.

- Vlerësimi i mundësive reale për hapjen e ciklit të tretë të studimeve, mundësisht brenda viteve akademike 2018-2020.
- Krijimi i standardit të kërkimit shkencor.
- Studimin e mundësive organizative për konferenca shkencore, në funksion të artit në përgjithësi.
- Studimin e aspekteve menaxhuese, ekonomike dhe sociale të artit në Shqipëri.
- Zgjerimin e marrëveshjeve dypalëshe në funksion të ecurisë së ndërsjellë, për ciklin e tretë të studimeve duke marrë eksperiencat më të mira të tyre.
- Vlerësimi i përvojës shumë vjeçare të brezave elitare në fushën e artit, nëpërmjet konferencave shkencore.

6. Produktet kryesore që do të ofrohen së bashku me kërkimin shkencor;

- Programe Kombëtare artistike në sallat e UA.
- Programe Ndërkombëtare artistike për të gjitha zhanret e artit.

7. Standardet e politikës të programit;

- Standarde të plotësuara në drejtim të pajisjes me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UA.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik dhe administrativ.
- Akreditim i programeve të studimit të ofruara nga UA për të dy ciklet e studimit Bachelor dhe Master
- Standard për plotësimin e tre cikleve të studimeve në UA, duke hapur edhe programin e shkollës doktorale.

8. Objektivat viti 2018-2019 e vazhdim

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në UA, nëpërmjet:





- Rishikimit të kurikulave në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.
- Nivel bashkëkohor i kurikulës.
- Pasurimi i laboratorëve dhe sigurimit të teknologjive të mësimdhënies.
- Sigurimi i cilësisë institucionale dhe i programeve të studimit.
- Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të ambienteve të UA.

9. Produktet kryesore që do të ofrohen në 2018 e vazhdim

- Laboratorë dhe zyra të pajisura, sipas standardeve të kërkuara për to.
- Biblioteka e pajisur me literaturë në ndihmë të procesit akademik të mësimdhënies.

10. Objektivat kryesore për kërkimin shkencor vitin 2018 e vazhdim

- Ngritja e grupeve të punës për hartimin e programeve të studimit të ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë.

11. Objektivat viti 2018 e vazhdim

- Cilësi në mësimdhënie.
- Trajnim të stafit akademik.
- Pasurimit të laboratorëve me teknologjinë e kohës për mësimdhënien.
- Sigurimi i cilësisë institucionale dhe i programeve të studimit.
- Zgjerimit të ambienteve të UA nëpërmjet ndërtimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave ekzistuese.
- Staf akademik i kualifikuar.

12. Produktet kryesore që do të ofrohen në 2018 e vazhdim

- Sipërfaqe të përfuara nga ndërtimi i godinave të reja.
- Vënia në funksionim e sipërfaqeve të mjediseve mësimore të përfuara.

13. Objektivat kryesore për kërkimin shkencor viti 2018 e vazhdim

- Miratim të programeve të studimit të ciklit të tretë të studimeve, në Doktoratë si dhe fillimin e studimeve në shkollën e doktoratës.
- Financimi i projekteve kërkimore shkencore.
- Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor për UA.



- Zgjerimi i aktiviteteve për përfshirjen e biznesit privat ne programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve.

14. Produktet kryesore që do të ofrohen në 2018 e vazhdim

- Studime të ndryshme kërkimore shkencore sipas një plani të miratuar nga Senati për fushat përkatëse të UA.

15. Standardet e politikës të programit 2018 e vazhdim

- Te plotësohen standardet për pajisjen me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UA.
- Përfshirjen e të paktën rreth 80% të studentëve që diplomohen në Bachelor për të ndjekur studimet në ciklin e dytë të studimeve Master.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik dhe administrativ.
- Të punohet për akreditimin e programeve të studimit të ofruara nga UA për të dy ciklet e studimit Bachelor dhe Master.

